

Roli i gjyqësorit në procesin e rishikimit periodik universal (RPU)

Rishikimi Periodik Universal (RPU) është instrument specifik i Këshillit të të Drejtave të Njeriut për të ndjekur gjendjen e të drejtave të njeriut në të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara (OKB).



Rishikimi është i bazuar në cikle: Çdo shtet rishikohet një herë në çdo 4,5 vite, ndërsa procesi është i ndarë në cikle.



Rishikimin e implementon Grupi Punues i RPU-së i përbërë nga 47 anëtare të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, por çdo shtet anëtar i KB-së mund të merr pjesë dhe të jep rekomandime.



Grupë e tre shteteve (e njohur si "Trojka") zgjidhet që të udhëheq dhe lehtësojë procesin.



Rishikimi bëhet përmes dialogut interaktiv: shteti që rishikohet prezanton raportin e vet ndërsa pastaj shtetet tjera parashtrojnë pyetje, komente dhe rekomandime.

Fazat e kyçes të sistemit gjyqësor në procesin e RPU-së

1 Para rishikimit

Pjesëmarrje në konsultimet kombëtare dhe paraqitje e informacioneve mbi raportin shtetëror;

Raportim për çështjet më të rëndësishme gjyqësore që ndikojnë në zhvillimin e të drejtave të njeriut;

Ngritja e kapaciteteve të gjyqtarëve dhe forma të tjera të kontributit gjyqësor në mekanizmin e RPU-së.

2 Gjatë rishikimit

Pjesëmarrje me delegacionin kombëtar për rishikim të informuar.

3 Pas rishikimit

Informata nga Ministria për Punë të Jashtme dhe Tregti të Jashtme mbi matricën e rekomandimeve të miraturo;

Përfshirja e rekomandimeve të RPU-së në trajnimet për gjyqtarët dhe stafin gjyqësor;

Krijim të mekanizmave të brendshëm brenda gjyqësorit për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të RPU-së.